



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKTVENDIM

NR. _____, DATË ____ / ____ / 202__

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT TË NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË
BASHKËPUNIT MIT MIDIS BASHKISË DURRËS DHE SPITALLA SOLAR SHPK
ME QËLLIM TRANSFERIMIN E TË DREJTËS SË PËRDORIMIT TË
INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, KËSAJ
SHOQERIE NË FUNKSION TË NDËRTIMIT TË PARKUT
FOTOVOLATIK TË SPITALLËS ME NJË KAPACITET
PREJ 100 MEGAVAT ENERGJI**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjin Nr. 24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, VKM-së Nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”, ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 906, datë 18.11.2020 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të pronës shtetërore me numra pasurie 46, 47, 48, 49, 50, 63, 64, 65, 66, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, në zonën Ish-Kënetës, Spitallë ndryshuar me VKM- në 478, datë 13.07.2022 është përcaktuar sipërfaqja e zonës teknologjike dhe zhvillimit ekonomik të shpallur me VKM-në nr. 262, datë 06.04.2016 “Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës” sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike dhe Drejtoria e Shërbimeve, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Durrës dhe Shoqërisë “Spitalla Solar” Shpk me objekt transferimin e së drejtës të përdorimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit të ndodhura brenda vendndodhjes sipas hartës bashkëngjitur këtij projektvendimi.

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej Tij, për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Durrës dhe Shoqërisë “Spitalla Solar” Shpk me objekt transferimin e së drejtës të përdorimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit të ndodhura brenda vendndodhjes sipas hartës bashkëngjitur këtij projektvendimi.
3. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Vendore, Drejtoria Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja Rruga, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.


**PËR DREJTORINË E PLANIFIKIMIT
DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT
TË TERRITORIT**

**Drejtör
Robert Deryishi**



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

**Drejtör
Ardian Hjazaj**



**PËR DREJTORINË E PROJEKTEVE
DHE INFRASTRUKTURËS PUBLIKE**

**Drejtör
Lorenç Facja**




PËR DREJTORINË LIGJORE


**Drejtör
Alneida Broshi**



KRYETAR

Emiriana Sako






KOORDINATAT E PARCELAVE SIPAS HTR

Parcela 46				Parcela 47				Parcela 48				Parcela 49				Parcela 50			
Nr.	E	N		Nr.	E	N		Nr.	E	N		Nr.	E	N		Nr.	E	N	
1	454167.859	4582043.228		1	453996.789	4581947.870		1	453821.760	4581854.638		1	453653.304	4581764.929		1	453475.525	4581670.115	
2	454527.236	4581375.870		2	454360.282	4581282.623		2	454185.808	4581184.253		2	454009.108	4581094.402		2	453833.722	4580998.638	
3	454360.282	4581282.623		3	454196.588	4581190.334		3	454019.551	4581100.005		3	453840.634	4581002.406		3	453679.039	4580912.194	
4	454007.495	4581953.844		4	453832.685	4581860.457		4	453661.793	4581769.452		4	453482.479	4581673.899		4	453317.685	4581586.134	
Parcela 63/1				Parcela 64/1				Parcela 65/1				Parcela 66/1							
Nr.	E	N		Nr.	E	N		Nr.	E	N		Nr.	E	N					
1	453843.440	4580980.905		1	454016.060	4581075.211		1	454195.399	4581166.591		1	454369.205	4581266.241					
2	453689.529	4580894.909		2	453853.652	4580986.527		2	454025.189	4581080.187		2	454204.883	4581175.058					
3	454008.448	4580916.233		3	454165.994	4580399.102		3	454343.227	4580492.326		3	454522.831	4580589.561					
4	454158.297	4580995.053		4	454335.453	4580488.237		4	454517.916	4580581.892		4	454686.578	4580675.558					
Parcela 63/2				Parcela 64/2				Parcela 65/2				Parcela 66/2							
Nr.	E	N		Nr.	E	N		Nr.	E	N		Nr.	E	N					
1	454158.297	4580995.053		1	454335.453	4580488.237		1	454517.916	4580581.892		1	454686.578	4580675.558					
2	454008.448	4580916.233		2	454165.994	4580399.102		2	454343.227	4580492.326		2	454522.831	4580589.561					
3	454074.035	4580197.138		3	454229.062	4580280.489		3	454406.283	4580375.774		3	454586.351	4580472.589					
4	454221.929	4580276.654		4	454398.828	4580371.766		4	454575.453	4580466.730		4	454748.726	4580559.892					

Nr.	Zona Kadastrale	Nr Pasune	Nomeklatura	Sip (m ²) sipas Karteles se Pasune
1	DR8517SP	46	K-34-87-(239-B)	142.500
2	DR8517SP	47	K-34-87-(239-A,B)	141.000
3	DR8517SP	48	K-34-87-(239-A)	140.250
4	DR8517SP	49	K-34-87-(239-A)	146.375
5	DR8517SP	50	K-34-87-(239-A,C)	135.000
6	DR8517SP	63/1	K-34-87-(239-C)	117.200
7	DR8517SP	63/2	K-34-87-(239-C)	25.000
8	DR8517SP	64/1	K-34-87-(239-C,D)	127.200
9	DR8517SP	64/2	K-34-87-(239-C)	28.035
10	DR8517SP	65/1	K-34-87-(239-D)	122.700
11	DR8517SP	65/2	K-34-87-(239-C)	25.030
12	DR8517SP	66/1	K-34-87-(239-C)	123.500
13	DR8517SP	66/2	K-34-87-(239-C)	25.020
				SIP M ² 1,298,810.00
				SIP ha 129.88

EMITIM (VIZITIM)		PLANVENDOSJA E PERQJITHSME E PRONES PER RRETHIM	
VENDOSJA: Bujar Karanxha	Emetja: Bujar Karanxha	Nr. Fletës: 51	Shkalla 1:000
Emetja: Bujar Karanxha		Format: A2	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

RELACION

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT TË NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË
BASHKËPUNIT MIDIS BASHKISË DURRËS DHE SPITALLA SOLAR
SHPK ME QËLLIM TRANSFERIMIN E TË DREJTËS SË PËRDORIMIT
TË INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, KËSAJ
SHOQERIE NË FUNKSION TË NDËRTIMIT TË PARKUT
FOTOVOLATIK TË SPITALLËS ME NJË KAPACITET
PREJ 100 MEGAVAT ENERGJI.**

PARA KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltarë!

Bazuar në Ligjin nr.1397/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin Nr. 24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, VKM-së Nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”, ju paraqesim relacionin si më poshtë :

Projekt vendimi që po ju paraqesim për miratim, ka për qëllim dhënien e miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak të nënshkrimit të bashkëpunimit midis Bashkisë Durrës dhe SPITALLA SOLAR Shpk, e cila ka shprehur interesin të përdorë pa kundërshtpërblim rrjetin e infrastrukturës së ujitjes, të kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja në administrim të Ndërmarrjes Rrugë. Administrata e bashkisë për propozimin e mësipërm, propozim i cili pritet të marrë miratimin tuaj, është vënë në lëvizje me shkresën 3032 prot., datë 03.03.2025 ardhur nga Shoqëria “SPITALLA SOLAR” Shpk, me anë të së cilës i kërkon institucionit të Bashkisë marrjen pa kundërshtpërblim, për një afat 10 vjeçar, të rrjetit të infrastrukturës së ujitjes, të kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja në administrim të Ndërmarrjes Rrugë.

Bazuar në Ligjin Nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, Bashkia bazuar në Nenin 7 të këtij ligji është përgjegjëse për inventarin e infrastrukturës së ujitjes, të kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja, të transferuar në pronësi të tyre. Gjithashtu bazuar në nenin 8 të këtij ligji

parashikohet që dhënia në përdorim e infrastrukturës mbi bazën e së drejtës kontraktuale bëhet me marrëveshje me shkrim, në formën e parashikuar, ndërmjet ministrisë/bashkisë dhe cilitdo që i transferohet infrastruktura, për jo më pak se 10 vjet. Në marrëveshje përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës.

Lidhur me projektin në fjalë sqarojmë se me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 906, datë 18.11.2020 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të pronës shtetërore me numra pasurie 46, 47, 48, 49, 50, 63, 64, 65, 66, pjesë e zonës kadastrale nr.8517, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, në zonën Ish-Kënetës, Spitallë ndryshuar me VKM- në 478, datë 13.07.2022 është përcaktuar sipërfaqja e zonës teknologjike dhe zhvillimit ekonomik të shpallur me VKM-në nr. 262, datë 06.04.2016 "Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës". Bazuar në legjislacionin në fuqi, Shoqëria Voltitalia S.A ka nënshkruar marrëveshjen përfundimtare për zhvillimin e projektit (MPZHP) me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zhvillimin, ndërtimin, financimin, kolaudimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen për një periudhë 30 vjeçare të Parkut Fotovoltaik të Spitallës me një kapacitet prej 100 megavat energji. Parku Fotovoltaik që do të ndërtohet nga Shoqëria "Spitalla Solar" shpk shtrihet në një sipërfaqe totale prej 129.88 hektarë tokë të cilat janë transferuar në administrimin e MIE, e cila nëpërmjet shkresës nr. 4576/1 prot., datë 26.06.2025, protokolluar me tonën 3032/3 prot., datë 27.06.2025 autorizon bashkinë për vijimin e procedurave të mëtejshme për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.


Duke qenë se objekti i këtij relacioni është dhënia e miratimit nga ana juaj për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Durrës dhe Shoqërisë "Spitalla Solar" Shpk me objekt transferimin e së drejtës të përdorimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit të ndodhura brenda vendndodhjes sipas hartës bashkëngjitur këtij relacioni, kërkojmë miratimin tuaj për vijimin e procedurave të mëtejshme për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

Ndodhur në këto kushte, me qëllim realizimin e një detyrimi ligjor që kanë institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për investimet strategjike i kërkojmë Këshillit Bashkiak që të shprehet me vendim për miratimim e vijimit të procedurave të mëtejshme.

Duke ju falenderuar,


DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Drejtore


Ardian Haxaj

NDËRMARRJA RRUGA

Drejtore


Alion Hysko

**PËR DREJTORINË E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT
Robert Dervishi**



**PËR DREJTORINË E PROJEKTEVE DHE INFRASTRUKTURËS PUBLIKE
Lorenc Fajja**

